



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-065
Prishtinë, më 25 maj 2016

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 25 MAJ 2016**

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Për ndryshimin e rendit të ditës u paraqitën këta deputetë:

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, propozoi që pika e pestë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme, me arsyetimin se kanë nevojë për konsultime të mëtutjeshme me Komisionin Funkcional.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar.

Kuvendi me shumicë votash vendosi që pika e 5-të e rendit të ditës - Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, të shtyhet për seancën e radhës.

Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit për Administratën Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, propozoi që shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës, që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, të përfshihet në rend dite të seancës së sotme, me procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe neni 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartshënuar.

Për propozimin që të përfshihet në rend dite edhe shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës, që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, diskutuan këta deputetë: Melihate Tërmkolli, Ismet Beqiri, Ganimete Musliu, Shpejtim Bulliqi, Adem Grabovci dhe Slavko Simiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi me shumicë votash vendosi që shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës, që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, të procedohet për seancën e ardhshme plenare.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet sipas pikave të rendit të ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, z. Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Për këtë projektligj diskutoi edhe nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Në këtë projektligj ishin paraqitur 37 amendamente.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara sipas radhitjes nga Komisioni FunkSIONAL. Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 24, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36 dhe 37.

Në fund, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----58,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Deputetja Selvije Halimi, në emër të Komisionit Funksional për Legjislacion, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Deputetja Jasmina Zhivković propozoi që Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës të mos votohet në seancën e sotme, me arsyetimin se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve nuk e ka shqyrtuar këtë projektligj, edhe pse i kishte kaluar të gjitha afatet kohore të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Lidhur me Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës diskutuan edhe këta deputetë: Milena Milićević, Sabri Hamiti, Selvije Halimi, Veton Berisha dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në këtë projektligj ishin paraqitur 6 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara.
Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 3, 4, 5 dhe 6.

Zëvendëskryeministri Kujtim Shala, në emër të Qeverisë së Kosovës, propozoi që ky projektligj të shtyhet për seancën e ardhshme plenare.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e zëvendëskryeministrit Kujtim Shala.

Kuvendi me shumicë votash vendosi që Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës të shtyhet për seancën e ardhshme plenare.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Deputetja Salihe Mustafa, në emër të Komisionit Funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin paraqitur 17 amendamente.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17.

Në fund, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për procedurën e përgjithshme administrative dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti Sadri Ferati, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime të harmonizuara me Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqytjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Në këtë projektligj ishin paraqitur 48 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara, sipas radhës së paraqitur nga Komisioni FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 3, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47 dhe 48.

Në fund, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 71,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative.

5. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, e kanë shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar për miratim.

Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, znj. Duda Balje, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, z. Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin financiar të komisionit.

Lidhur me raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2015 diskutuan: Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Adem Salihaj, në emër të GP të LDK-së, si dhe deputetët Abdyl Ymeri, Bekim Haxhiu, Shaip Muja, Ganimete Musliu, Blerata Deliu-Kodra dhe Salih Morina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----45,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 14.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2015.

6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Medie për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, e kanë shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Medie për vitin 2015 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar për miratim.

Kryesuesi i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, z. Zenun Pajaziti, e paraqiti dhe e arsyetoi raportit me rekomandimet e Komisionit Funkcional.

Kryesuesi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, z. Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin financiar të komisionit.

Lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Medie diskutuan: Xhevahire Izmaqi, në emër të GP të PDK-së dhe Sadri Ferati, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Medie për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 57,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Medie për vitin 2015.

7. Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e

kanë shqyrtuar raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi e ftoi Avokatin e Popullit që ta paraqesë raportin.

Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015, fjalimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Deputetja Salihe Mustafa, në emër të Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, z. Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor financiar.

Lidhur me raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015 diskutuan: Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të GP të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së; Nenad Rashiq, në emër të GP LS; Kujtim Paçaku, në emër të GP “6+”, si dhe deputetët Shaip Muja, Emilija Rexhepi dhe Veton Berisha, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	65,
Kundër -----	3,
Abstenime -----	1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015.

8. Shqyrtimi i raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Deputetja Selvije Halimi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, z. Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor financiar.

Lidhur me raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015 diskutuan Agim Aliu, në emër të GP të PDK-së dhe Agim Ademaj, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015.

Kryesuesi i mbylli punimet e kësaj seance në orën 13:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale